



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KOMITETI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e komitetit për **Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e pesta** me radhë, e mbajtur më datë **21.11.2024 (e enjte)**, me fillim në ora **10:00**

Mbledhjen e kryesoi kryesuesja e komitetit, **znj. Almedina Jaha**. Të gjithë anëtarët e komitetit ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Diskutimi rreth organizimit të tryezës së rrumbullakët për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, me OJQ-të e Komunës së Rahovecit;**
- 3. Diskutimi me DKRS-në dhe OJQ-të të cilat merren me persona me aftësi të kufizuara, rreth organizimit të ndonjë aktiviteti me persona me aftësi të kufizuara për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara;**
- 4. Informatë nga drejtorja e arsimit (DKA), rreth përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, infrastrukturës për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe sfidat e tjera;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesja: Mirëmëngjesi! Përshëndetje për të gjithë! Jemi mbledhur sot në takimin e pestë të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara. Falënderim për pjesëmarrje për drejtoreshën e shoqatës “Hareja”, Adelina Paqarizi, drejtorin e DKRS-së, Afrim Dina si dhe drejtorin e DKA-së, Avni Morina. Të nderuar pjesëmarrës, vazhdojmë me leximin e rendit të ditës. Atëherë pas leximit, rendin e ditës si të tillë e vendosim në votim! Kush është “pro”?... Unanimisht aprovohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesja: Atëherë, nëse dikush ka ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim, kush është “për”?... Unanimisht aprovohet procesverbali.

2. Diskutimi rreth organizimit të tryezës së rrumbullakët për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, me OJQ-të e Komunës së Rahovecit:

Kryesuesja: Atëherë, kjo pikë dhe pika e tretë janë përafërsisht të ngjashme. Është mirë të merremi vesh që për datën 3 dhjetor të organizojmë ndonjë aktivitet për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara. Jemi të hapur për ndonjë ide!

Afrim Dina: Faleminderit! DKRS-ja edhe me plan të punës organizon aktivitete të ndryshme brenda mundësive që i ka, në bashkëpunim me OJQ-të në komunën tonë, siç është “Hareja”, “SHL-Kosova”, etj. Mendoj që është mire të organizojmë edhe për 28 Nëntor. Ne kemi pasur më herët aktivitet aty në palestër sportive, bashkëpunim me shoqatën “Hareja”. Aktiviteti është mirë të mbahet më datë 27 nëntor. Gjithësesi më date 3 dhjetor do të organizohet një aktivitet tjetër për nder të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara.

Kryesuesja: Faleminderit! A jeni të pajtimit të vazhdojmë me aktivitetet në palestër dhe jo me tryezë? Apo keni ndonjë propozim tjetër?

Atdhe Rama: Propozoj që ta bëjmë një tryezë të përbashkët. Nuk jemi nevojë të ndahemi, por ta bëjmë të gjithë bashkë, Hareja, SHL Kosova, Hendikosi dhe Komuna. Vendi se ku e bëjmë nuk ka rëndësi shumë, por duhet të bëhet bashkë dhe me shumë mysafirë e institucione që t’i diskutojmë sfidat që i kanë personat me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit. Tutje mund ta bëjmë edhe një aktivitet sportiv dhe t’i bashkëngjitemi “Harejës” e cila dëshiron ta ftojë një person VIP për vizitë.

Afrim Dina: Aktivitetet do t’i organizojë komuna në bashkëpunim me shoqatën “Hareja”. Për vendin dhe orën aktiviteteve mund të merremi vesh. Aktiviteti sportiv është mirë të jetë pjesë e 28 Nëntorit. Me 3 nëntor mund të mbajmë tryezë me mundësitë që i kemi si komunë.

Adelina Paçarizi: Ju falënderoj për ftesën dhe pajtohem që të bëjmë diçka bashkërisht. Vitin e kaluar e kemi mbajtur një tryezë, keni qenë të ftuar të gjithë dhe kemi diskutuar për gjendjen aktuale të personave me nevoja të veçanta në komunën tonë. Nëse e organizojmë tryezën edhe sivjet, mund ta mbajmë në sallën e shoqatës “Hareja”. Propozoj që tryezën ta mbajmë me 2 dhjetor dhe është mirë që pas tryezës, mysafirët t’i dërgojmë për drekë. Sa i përket aktivitetit në palestër, më datë 27 ne i planifikuar disa aktivitete tradicionale me muzikë patriotike me fëmijë dhe ndoshta është mirë që fillimisht t’ia fillojmë në “Hareja” më pas prej orës 13:00 të shkojmë në palestër.

Atdhe Rama: Atëherë, aktivitetin mund ta bëjmë më datë 27, pasi është edhe ditë pushimi.

Afrim Dina: Mirë shumë që jeni duke e organizuar këtë aktivitet me fëmijë pikërisht më datë 27, pastaj është mirë që fëmijët të vijnë në palestër për t’u bashkëngjitur me aktivitetin e organizuar aty.

Skender Hamza: Përshëndetje! Këtu janë duke u diskutuar pika e dytë dhe e tretë. Qëllimi është që Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuara të jetë pjesë e këtij aktiviteti.

Sead Raba: Mund ta bëni një kërkesë, me një arsyetim se çfarë aktiviteti do të organizohet dhe të njëjtin do ta përcjelli te zyrtarët e lartë dhe t’i shohim mundësitë nëse mund t’ju përkrahim. Do të jemi në kontakt me Skenderin dhe kryesuesen.

Kryesuesja: Atëherë, më 27 aktiviteti sportiv dhe më datë 2 dhjetor tryeza. Besoj që jemi të pajtimit të gjithë.

Afrim Dina: Shumë mirë, atëherë me 27 aktiviteti sportiv në palestër, me persona me aftësi të kufizuara dhe më 2 dhjetor tryeza te “Natyra”, 20-25 persona. Tryeza fillon në ora 10:00, dreka në 12:00.

Selman Shtavica: Neve na mungon transporti për transportimin e personave me aftësi të kufizuara, ndërsa shumë prej tyre i kemi në fshatra. Kërkoj që për datën 3 dhjetor të na siguroni një transport dhe në qoftëse nuk mund të gjendet buxheti për organizimin e drekës. Unë si shoqatë “Hendikos” 50% mund ta mbuloj, përkundër asaj që jemi në gjendje jo të mirë financiare. Një pyetje tjetër: Afrim, a je i informuar që dy persona me aftësi të kufizuara nga Komuna e Rahovecit luajnë për kombëtaren e Kosovës në futboll, a keni kontakt me këta?

Afrim Dina: Tani bëhen dy vite kur është themeluar shoqata e sportistëve parapragjikë. Jam në dijeni që ata luajnë për kombëtaren dhe kam menduar që kur të zgjidhet sportisti i vitit, t’i vlerësojmë si komunë.

Kryesuesja: Faleminderit drejtor! Atëherë, meqë u diskutuan dy pikat menjëherë, vazhdojmë me pikën e katërt.

4. Informatë nga drejtorja e arsimit (DKA), rreth përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, infrastrukturës për qasje të personave me aftësi të kufizuara dhe sfidat e tjera:

Avni Morina: Faleminderit kryesuese! Si drejtor i DKA-së ju njoftoj që ne kemi një numër të caktuar të fëmijëve që janë me nevoja të veçanta, që janë të përfshirë në të gjitha nivelet e shkollimit. Ne si DKA me kushtet që i kemi

në dispozicion, po mundohemi t'i dalim në ndihmë maksimalisht kësaj kategorie të fëmijëve. Pothuajse në të gjitha objektet e shkollave tona janë të ndërtuar pjerrinat, të cilat lehtësojnë qasjen e personave me aftësi të kufizuara dhe lehtësime të qasjes brenda objektit të arsimit. Për momentin, si sfidë për ne është që e kemi të kufizuar numrin e asistentëve për nevoja të veçanta arsimore. Me buxhetin që e kemi punësuar një numër të caktuar të asistentëve për nevoja të veçanta arsimore, i kemi 5 sosh dhe janë mjaft pak, sepse ne i kemi 26 shkolla fillore, 4 shkolla të mesme dhe 4 çerdhe dhe në të gjitha këto institucione arsimore ka fëmijë me nevoja të veçanta arsimore, si dhe me aftësi të kufizuara. Përkundër faktit që Ministria e Arsimit trumbeton, nga kjo e fundit dhe nga qeveria e Republikës së Kosovës nuk kemi pasur përkrahje buxhetore dhe ndarje të veçantë buxhetore për punësimin e asistentëve për fëmijë me nevoja të veçanta. Këta 5 asistentë që i kemi punësuar, janë prej buxhetit tonë komunal, duke lënë diçka anash te arsimit fillor apo i mesëm i lartë.

Selman Shtavica: I kam tre pyetje për drejtorin! Sa është numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në Komunën e Rahovecit? Pse nuk ka banjë për persona me aftësi të kufizuara, me standarde të duhura? Pse nuk është formuar ende komisioni vlerësues për persona me aftësi të kufizuara, sepse atij që ka qenë i ka skaduar mandati?

Avni Morina: I nderuar, ju i bëtë tre pyetje, por vetëm kjo e para mund të jetë pyetje që mund t'i përgjigjem, sepse të tjerat janë edhe të sektorëve të tjerë të komunës. Te nyjet sanitare te toaletet, ato janë standarde pothuajse në të gjitha objektet. Mendoj që është kërkesë me vend. Sa i përket numrit të saktë, për momentin nuk e di edhe pse këto shënime ne i kemi si drejtori, por unë jam ithtar i asaj që të jem i saktë në shifra.

Selman Shtavica: Faleminderit! Nëse ka mundësi të ma jepni një material rreth numrit të personave me aftësi të kufizuara, ta kem si databazë në hendikos.

Avni Morina: I autorizoj zyrtarët dhe kur të përfundon takimi materialin do ta kesh në email.

Atdhe Rama: Me ligj të ri, të gjitha sëmundjen janë duke u përkufizuar me një term të vetëm si "persona me aftësi të kufizuara". Ka persona me të meta fizike, mendore dhe me sëmundje gjenetike. DKA-ja mund t'i mos ketë të dhënat e sakta, sepse ka persona që nuk mund të vërehen nëse janë apo jo me aftësi të veçanta, si në rastin e sëmundjeve gjenetike. Vajza ime është me një sëmundje gjenetike dhe sot është një bursiste, është në klasë të shtatë dhe është një prej nxënësve më të mira. Unë jam shumë i kënaqur me mënyrën se si po trajtohen fëmijët me aftësi të kufizuara në komunën tonë.

Adelina Paçarizi: Selmani e përmendi komisionin, nuk e di se për çfarë komisioni e ka pasur fjalë, por nëse e ka pasur për që ata të marrin ndonjë pension për arsye që janë persona me aftësi të kufizuara, është problem regional dhe problem qëndror. Janë funksionale deri diku, por, nuk është kompetencë e komunës. Te bashkëpunimi prindër-fëmijë-mësimdhënës: Problemi qëndron më shumë te prindërit, sepse unë i kuptoj edhe ata, se asnjë nuk e pranon që e ka një fëmijë me nevoja të veçanta dhe kur bashkohet me neve në shoqatë, më thotë që mjeku i ka thënë që fëmija të shoqërohet, por nuk tregon se çka ka ai fëmijë. Pas 2-3 dite e vërejmë që fëmija është me aftësi të veçanta, ia kërkojmë dokumentacionin që tani ta kemi më të lehtë punën. Kemi pasur shumë telashe deri sa i kemi bindur prindërit për një gjë të tillë. Fatkeqësisht ende vazhdon kjo, sepse ndoshta ndihen të stigmatizuar, apo diçka të tillë.

Avni Morina: Ato që desha t'i thoja, i tha Adelina! Vërtetë njëra prej sfidave që është, është bashkëpunimi me prindër të fëmijëve në këtë kategori. Ka një numër të caktuar të prindërve që nuk janë bashkëpunues dhe që nuk e pranojnë realitetin dhe ka hezitime. Sa i përket komisioneve, ju lutem, DKA-ja i shqyrton vetëm në aspektin edukativ, sepse jemi staf arsimor. Besoj që këtë gjë do të mund ta bëjë Drejtoria e Shëndetësisë, apo ndonjë sektor tjetër. Ne nuk jemi kompetentë që dikujt t'ia caktojmë diagnozën, se çfarë sëmundje ka ose çfarë aftësie i mungon.

Selman Shtavica: E kemi edhe një fëmijë nga Retija, është i regjistruar te ne dhe është me autizëm. Shtrohet pyetja pse e vijon mësimin? Për këtë arsye dhe për shumë tjera, kërkoja që të bëhet ai komision.

Atdhe Rama: Nëse ka bazë ligjore, ky komision duhet të shqyrtohet. Mund ta dërgojmë një shqetësim në DKA, duke thënë që ky komision kërkohet sipas ligjit dhe duhet të formohet nga viti i ardhshëm.

Altina Mezini: Fillimisht, i falënderoj të gjitha drejtoritë që i janë përgjigjur pozitivisht në ftesës për këtë komitet. Një pyetje e kam për të dy drejtorët: Sa është numri i personave në stafin e juaj me nevoja të veçanta?

Afrim Dina: Në DKRS, për momentin të punësuar nuk kemi. Më herët kanë qenë si pjesë të praktikave, i presim edhe në të ardhmen. Si drejtori, do t'i ndihmojmë kushdo që ka nevojë.

Avni Morina: As në stafin e DKA-së nuk kemi të punësuar persona me aftësi të kufizuar. Në Guri të Kuq e kemi një mësues, i cili në njërin këmbë ka probleme dhe mezi e bën ecjen. E kemi një profesoresh në gjimnaz, që gjithashtu ka probleme me njërin këmbë. E kemi një punëtor teknik mjaftë e të mirë te shkolla profesionale, i cili ka ngecje në të folur. Fatmirësisht, mësidhënësve këto aftësi të veçanta nuk u pengojnë në zhvillimin e procesit mësimor.

5. Të ndryshme:

Kryesuesja: Jemi te pika e fundit, nëse dikush ka diçka për të shtuar? Nëse jo, atëherë, ju falënderoj për kontributin, shihemi në mbledhjet e radhës.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

Kryesuesja e komitetit:

Almedina Jaha